



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:233955
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380052

C - IV. - 15 - 1915

Paditësi :

Zh S nga fshati P i Komunës së Gjilanit e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. M M nga Gjilani.

Kundër:

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i vlerës së mallit – grurit.

Për : Palët në procedurë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt.27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Zh S nga fshati P Komunës së Gjilanit e më të cilën ka kërkuar që të:” Obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë që paditësit, t’ia kompensoj sasinë e grurit prej 3,100 kg edhe atë në kundërvlerën në para me kamatë nga dita e dorëzimit të grurit deri në ditën e përmbushjes së grurit deri në përmbushjen e obligimit për mjetet e deponuara në bankë pa destinim të veçantë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti edhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me dt.29.10.2015, paditësi, Zh S nga fshati P i Komunës së Gjilanit, përmes të të autorizuarit të tij, av.M Mnga Gjilani pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DHPGJSK), ka parashtruar padi kundër të paditurës, NSh, ”Kualiteti” me seli në Gjilan (në likuidim) për kompensimin e sasisë e grurit prej 3,100 kg edhe atë në kundërvlerën në para me kamatë nga dita e dorëzimit të grurit deri në ditën e përmbushjes së grurit deri në përmbushjen e obligimit për mjetet e deponuara në bankë pa destinim të veçantë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti edhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Paditësi në këtë padinë në mes tjerash ka theksuar se ai është prodhues bujqësor, dhe nga prodhimi i tij bujqësor me aktin nr.1277 të datës 03.06.1999 tek Ndërmarrja Shoqërore, (NSh) "Kualiteti" me seli në Gjilan, ka dorëzuar sasinë prej 3,100 kg grurë, se me rastin e dorëzimit të kësaj sasive, i njëjti ka pasur të drejtë të marr miell sipas nevojave për sasinë e dorëzuar, se më pas meqë ishte gjendje lufte, i njëjti nuk ka mundur me e realizuar këtë të drejtë, se më pas i njëjti pasi janë krijuar kushtet dhe është stabilizuar situata i është drejtuar personelit të kësaj organizate për përgjigje ka marr se deri sa të stabilizohet situata dhe kështu më pas e njëjta është privatizuar dhe me të njëjtën ka menaxhuar e paditura, se kjo situatë ka vazhduar deri sa paditësi ka ardhur në dijeni se duhet të ushtroj kërkesë e të cilën e ka ushtruar me dt.23.11.2012, se paditësi gojarisht ka kërkuar përgjigje në këtë kërkesë por më kot dhe kështu me dt.21.10.2015, merr njoftimin nga e paditura me të cilin i bëhet me dije se është parashkruar afati i kërkesë dhe i refuzohet kërkesa e meqë paditësi konsideron se i takon e drejta në realizimin sipas kushteve që i ka pasur me NSh, "Kualiteti" me seli në Gjilan (në likuidim) për sasinë prej neto 3100 kg grurë i ka propozuar kësaj gjykate që pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe shtjellimit të provave të bie aktgjykim e me të cilin do t'i aprovohet padia dhe kërkesëpadija e tij dhe Obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë që paditësit, t'ia kompensoj sasinë e grurit prej 3,100 kg edhe atë në kundërvlerën në para me kamatën nga dita e dorëzimit të grurit deri në ditën e përmbushjes së grurit deri në përmbushjen e obligimit për mjetet e deponuara në bankë pa destinim të veçantë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti edhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe të obligohet e paditura që t'i kompensoj shpenzimet e procedurës.

Paditësi, kësaj padie,, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse: kopjen e njoftimin të dt.16.10.2015 të AKP-së, kopjen e Formularit të Plotësuar nga paditësi për kërkesën e tij e të dërguar në AKP, kopjen e kërkesës së dt.23.11.2012 të dërguar tek AKP-ja – AL-ja, kopjen e listës, dhe kopjen e aktit, Nr.1277 të dt.03.06.1999 derisa paditësi, kësaj gjykate i është drejtuar edhe me parashtrësën e dt.18.04.2017 për përshpejtimin e çështjes.

Me dt.10.08.2017, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj padisë së paditësit e në të cilën, ka theksuar se AKP-ja si përfaqësuese ligjor e të paditurës, i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij duke i konsideruar si të pa bazuar në ligj dh si e tillë duhet të refuzohet, se NSh, "Kualiteti" me seli në Gjilan, ishte futur në likuidim me Vendimin e AKM-së dhe me dt.31.12.2010, ka filluar procedura e likuidimit, se në këtë çështje juridike, ekziston litis pendenca – gjyqë varësia, se në procedurën e likuidimit, paditësi ishte parashtruar kërkesë kreditore përmes të cilës ka kërkuar kompensimin me dt.23.11.2012, se kjo kërkesë është shqyrtuar dhe vendosur nga ana e Autoritetit të Likuidimit e i cili autoritet ka vendosur me Vendimin e dt.16.01.2015, se i njëjti paditës, ka parashtruar ankesë/padi në Dhomën e Posaçme me numrin e rastin, C – IV. – 15 – 1914 ndaj së cilës Agjencia ka parashtruar mbrojtje në ankesë, se AKP-ja, konsideron se për këtë padi, ekziston litispendenca – gjyqë varësia dhe në kuptim të nenit 262 (par.3) të LPK-së, AKP-ja ka konsideruar se pretendimet e paraqitura në padi, nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret, e mungesat e tilla padinë e bëjnë të pa qëndrueshme andaj nga të gjitha arsyet e lartë përmendura, ka konsideruar se padia e paditësit, duhet të hedhet poshtë me arsye se a) litispendenca – gjyqë varësia dhe si e pa bazuar në aspektin ligjor dhe gjykata të merr aktvendim, dhe të hedhet poshtë si e pa lejueshme kërkesëpadija e paditësit ose të refuzohet si e pa bazuar në ligj padia e paditësit e më gjerësisht si në këtë mbrojtje dhe se kësaj mbrojtjeje i ka bashkangjitur, kopjen e shkresës së AKP-së të dt.31.01.2011 për NSh, "Kualiteti" me seli në Gjilan, të dërguar për DhPGjSK-në, njoftimet e dt.18 janar 2011 për likuidimin e kësaj NSh-je, kopjen e Formularit të Plotësuar nga paditësi për kërkesën e tij e të dërguar në AKP, dhe kopjen e kërkesës së paditësit e dt.23.11.2012 të dërguar tek AKP-ja – AL-ja.

Me dt.22.05.2023, DhPGJSK-ja me urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 1915 të dt.22.05.2023, mbrojtjen e të paditurës të paraqitur ndaj padisë së paditësit, ia ka dërguar paditësit e të cilën i autorizuari i tij, e ka pranuar me dt.25.05.2023 por se deri më tani, nuk ka prova se është përgjigjur në këtë Urdhër.

Me dt.26.02.2024, DhPGJSK-ja, duke iu ndërlidhur me pretendimin e palës së paditurës se në rastin konkret, kemi të bëjmë me gjyqe varësinë, sipas detyrës zyrtare në lëndën, C – IV. – 15 – 1914, ka gjetur aktvendimin e kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 1914 të dt.11 Nëntor 2022, padia e paditësit, është hedhur poshtë mbi bazën e pa pranueshmërisë së saj dhe se pas dërgimit të këtij aktvendimi, palëve në procedurë, kundër këtij aktvendimi, nuk është ushtruar ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesëpadia e paditësit, Zh S nga fshati Pi Komunës së Gjilanit, është e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e padisë/ankesës së paditësit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret padia/kërkesa e paditësit, pranë DhGJSK-së, e plotëson kriterin e pranueshmërisë së saj nga dispozitat e lartë cekura ligjore por se e njëjta padi/kërkesë, pranë e DhPGJSK-së, nuk i plotëson kriterin e bazueshmërisë së saj sepse para bërjes së padisë së paditësit pranë DhGJSK-së, paditësi, në procedurën e likuidimit, kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), e ka dorëzuar 30 (tri dhjetë) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave sepse afati për dorëzimin e kërkesës në procedurën e likuidimit, ka qenë deri me dt.19.03.2011 kurse parashtruesi, e këtu paditësi në procedurën e likuidimit kërkesën e tij e ka paraqitur tek me dt.23.11.2012 dhe se për këtë arsye, AL-ja, nuk ka vendosur me Vendim e me arsyetimin se kjo kërkesë, ishte bërë jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave.

Në nenin 36 Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) që flet për pranueshmërinë e një kërkesë/ankese, aty thuhet se: *''... Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; paditësi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtarë në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi kur janë të aplikueshme ... ''*.

Ndërsa lidhur me çështjen e afatit për të paraqitur një kërkesë në gjykatë nga një palë kreditore, në nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, parashihet se: *''Kreditore i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkitimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit ... ''*.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret padia/kërkesa e paditësit, pranë DhGJSK-së, e plotëson

kriterin e pranueshmërisë së saj nga dispozitat e lartë cekura ligjore por se e njëjta padi/kërkesë, pranë e DhPGJSK-së, nuk i plotëson kriterin e bazueshmërisë së saj sepse para bërjes së padisë së paditësit pranë DhGJSK-së, paditësi në procedurën e likuidimit, kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), e ka bërë - dorëzuar 30 (tri dhjetë) ditë pas kalimit të afatit për parashtrimin e kërkesave dhe se për këtë arsye, AL-ja, nuk ka marrë vendim për kërkesën e paditësit .

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësit me të paditurën, Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Kualiteti" me seli në Gjilan (në likuidim), kanë pasur raport gjegjës juridik dhe se e njëjta NSh, ishte futur në likuidim me Vendimin e AKM-së dhe me dt.31.12.2010, kur edhe ka filluar procedura e likuidimit (në likuidim) por kontestuese mbetet çështja e bazueshmërisë së kërkesëpadisë së paditësit e paraqitur përmes padisë në DhPGJSK kundër Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), "Kualiteti" me seli në Gjilan (në likuidim) sepse kërkesa e tij në procedurën e likuidimit, është bërë pas kalimit të afatit prej 30 ditëve për paraqitjen e saj pranë Autoritetit të Likuidimit (AL) dhe se për këtë arsye, AL-ja, nuk ka vendosur me vendimin gjegjës të saj për kërkesën e paditësit por se kërkesën e tij, nuk e ka konsideruar për procedim të mëtutjeshëm pranë Autoritetit të Likuidimit (AL) dhe atë duke u bazuar në nenin 35 par.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e të parapara si lloj i kërkesave, në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *"Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë"*.

Në nenin 42 par.2 dhe 3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashihet se : *"Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do ti jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë"*.

Në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, që flet për Njoftimin për kreditorin dhe afatin për parashtrimin të kërkesave, aty parashihet se : *"Në pajtim me nenin 7 të kësaj Shtojce, Autoriteti i Likuidimit publikon njoftim në pajtim me Dispozitat për shpallje duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që t'i parashtrojnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe të Interesit. Nëse Autoriteti i Likuidimit është duke shqyrtuar nëse një kërkesë është parashtruar si duhet brenda afatit përkatës kohor, ai trajton dërgimin e kërkesave në Agjenci si pezullim të llogaritjes së periudhës kohore pas asaj dërgese. Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo i Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për Parashtrimin e Kërkesave"*. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësi në procedurën e likuidimit, kërkesën e tij ndaj Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), "Kualiteti" me seli në Gjilan (në likuidim), ka pasur afat që t'a bëjë deri me dt.19.03.2011

mirëpo këtë kërkesë në procedurën e likuidimit të AL-ja, e ka bërë tek me dt.23.11.2012, pra 30 ditë pas kalimit të afatit për paraqitjen e saj në Autoritetin e Likuidimit (AL) dhe se për këtë arsye edhe Autoriteti i Likuidimit pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), nuk ka marr vendim dhe në bazë të nenin 35 par.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, kërkesën e paditësit, nuk e ka proceduar më tej në procedurën e likuidimit.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së të se kërkesa e paditësve në procedurën e likuidimit, në bazë të nenit 35 par.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), është bërë pas kalimit të afatit 30 ditor për dorëzimin e kërkesave të Autoriteti i Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), NSh, "Kualiteti" me seli në Gjilan (në likuidim), andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditësit, Zh S nga fshati P Komunës së Gjilanit për kompensimin e sasisë së grurit prej 3,100 kg edhe atë në kundërvlerën në para me kamatë nga dita e dorëzimit të grurit deri në ditën e përmbushjes së grurit deri në përmbushjen e obligimit për mjetet e deponuara në bankë pa destinim të veçantë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, duhet të refuzohet si e pabazuar për shkak se në procedurën e likuidimit, kërkesa e tij, është bërë pas kalimit të afatit të paraparë ligjor prej 30 (tridhjetë) ditëve për dorëzimin e kërkesave të Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36, 42, 54, dhe nenit 74 të Ligjit nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Shpenzimet Gjyqësore.

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata, vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:233955, 27.02.2024

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhGJSK).